



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. ____ prot.

Tiranë, më _____. 2025

**KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE TË DREJTAT E NJERIUT**

Të nderuar,

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, dhe udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2025, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026 – 2028”, ka përmbushur detyrimin ligjor për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2026 – 2028, miratuar me vendimin nr. 03, datë 25.4.2025, të Grupit për Menaxhimin Strategjik.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit (këtu e në vijim Kolegji) është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si një ndër tri institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Referuar nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Kolegji funksionon pranë Gjykatës Kushtetuese, si Kolegj i dytë i saj. Gjyqtarët e Kolegjit, referuar pikës 3, të nenit C, të Aneksit të Kushtetutës, gjatë mandatit të tyre gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Ndërkohë, bazuar në pikën 8, të nenit 179/b, të Kushtetutës, mandati i Kolegjit përfundon në qershor të vitit 2026 dhe, për këtë arsye, kërkesat buxhetore janë hartuar nga Ekipi i Menaxhimit të Programit dhe miratuar nga Grupi për Menaxhimin Strategjik, vetëm për vitin 2026.

Sa më sipër, është vlerësuar që buxheti për vitin 2026 të parashikohet në dy shtylla kryesore:

- I. Buxheti i nevojshëm në shpenzime korente dhe kapitale për funksionimin e Kolegjit, për periudhën janar-qershor 2026, në vlerë totale është rreth 208,124 mijë lekë.**

Ky buxhet është parashikuar për shpenzime korente dhe kapitale, referuar akteve ligjore në fushën e pagave, realizimin e shpenzimeve operative gjatë vitit 2024 dhe të pritshmin e vitit 2025, indeksimin e shpenzimeve me përcaktimet ligjore, çmimet referencë për materialet dhe shpenzimet sipas tregut etj.

Në këtë fond është përfshirë edhe një buxhet i përafërt, rreth **46 milionë lekë**, në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga Kodi i Punës, lidhur me shpërblimin për vjetërsi të punonjësve. Referuar nenit 152 të Kodit të punës, në përfundim të marrëdhënieve të punës, që kanë zgjatur jo më pak se tre vjet, punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsinë, si në rastin e zgjidhjes së kontratës me afat të pacaktuar nga punëdhënësi. Sipas nenit 145 të Kodit, shpërblimi për vjetërsi është të paktën sa paga e një 15-ditëshi, mbi çdo vit pune të plotë.

Gjithashtu, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj, detyrimin për pagesat kalimtare që përfitojnë pas largimit nga funksioni gjyqtarë të Kolegjit, bazuar në nenin 1, pika 8, dhe nenin 7, të ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, i cili ka një kosto financiare në vlerë rreth 9,100 mijë lekë. Duke qenë se buxheti për pagesat kalimtare çelet i veçantë nga Ministria e Financave, kjo kosto nuk është përfshirë në kërkesat buxhetore të Kolegjit për vitin 2026, megjithatë duhet të mbahet në konsideratë nga Ministria e Financave në planifikimet për vitin e ardhshëm buxhetor.

II. Buxheti i nevojshëm në shpenzime korente, për funksionimin e një strukture të posaçme për mbylljen e aktivitetit institucional, pas përfundimit të mandatit kushtetues të gjyqtarëve të Kolegjit, për periudhën korrik - dhjetor 2026, në vlerë totale, është rreth 93,275 mijë lekë.

Bazuar në nenin 70 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit pushojnë së funksionuari sipas nenit 179/b të Kushtetutës. Përveç rasteve kur autorizohet ndryshe nga Kuvendi, mandati i vetëm që vazhdon, është ai i Sekretarit të Përgjithshëm, i cili ka një personel të mjaftueshëm për të përmbushur detyrat.

Referuar këtij përcaktimi ligjor, vlerësojmë se do të jetë e nevojshme që të parashikohet miratimi i një strukture të posaçme, e përbërë nga Sekretari i Përgjithshëm dhe një numër i mjaftueshëm i stafit administrativ dhe Këshilltarëve të Njesisë së Shërbimit Ligjor, së bashku me buxhetin e nevojshëm, të paktën për një periudhë 6-mujore, korrik – dhjetor 2026. Kjo strukturë do të jetë përgjegjëse për mbylljen e aktivitetit institucional dhe do të përmbushë detyra që lidhen me veprime administrative të përgatitjes së dosjeve gjyqësore dhe arkivimit të tyre, arkivimin e dokumentacionit administrativ, transferimin e aseteve, hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare, procedura të burimeve njerëzore apo veprime të tjera të karakterit administrativ.

Për të dyja institucionet e tjera të rivlerësimit, Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerët Publikë, pas përfundimit të mandatit kushtetues të tyre, Kuvendi ka miratuar struktura të posaçme administrative për mbylljen e aktivitetit të tyre, me vendimin nr. 110/2024, “Për miratimin e organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” dhe vendimin e nr.111/2024, “Për miratimin e organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë”. Ndërkohë, me ligjin vjetor të buxhetit për vitin 2025, numri i punonjësve dhe buxheti për këto struktura është alokuar në programin buxhetor të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor të Ministrisë së Drejtësisë. Duke qenë se, referuar nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Kolegji funksionon pranë Gjykatës Kushtetuese, si Kolegji i dytë i saj, struktura për mbylljen e aktivitetit të Kolegjit dhe buxheti përkatës për funksionim e tij, për 6-mujorin e dytë të vitit 2026, mund të alokohet pranë Gjykatës Kushtetuese.

Në këtë fazë strategjike të hartimit të kërkesave buxhetore, në kushtet e mungesës së akteve përkatëse ligjore e nënligjore, me anë të të cilave do të rregullohet funksionimi i kësaj strukture, kemi vlerësuar që të parashikohet një numër rreth 60 punonjës, të Njesisë Administrative dhe Këshilltarë të Njesisë së Shërbimit Ligjor, dhe një buxhet i përafërt për funksionimin e kësaj strukture, parashikim, i cili për këtë fazë është paraqitur në Formatin nr. 3, “Politikat e reja”. Në rast të një vendimmarrje të ngjashme me atë të dy institucioneve të tjera të rivlerësimit, ky buxhet do të alokohet në një institucion tjetër, por në këtë moment vlerësojmë që ta paraqesim në këtë mënyrë, për t’i bërë prezent Kuvendit dhe Ministrisë së Financave, këtë kosto eventuale shtesë në buxhetin e shtetit për vitin 2026.

Në terma teknikë, për procesin e hartimit të kërkesave buxhetore në këtë fazë strategjike, janë ndjekur këta hapa:

1. Përcaktimi i misionit të institucionit dhe përshkrimi i programit buxhetor;
2. Përcaktimi i qëllimit të politikës dhe objektivave të programit;
3. Përcaktimi i treguesve të performancës për çdo objektiv të programit;
4. Formulimi i produkteve mbi bazën e rezultateve të përcaktuara;
5. Ndarja e kërkesave buxhetore sipas politikave ekzistuese dhe politikave të reja.

Misioni i KPA-së është: *“Përmbushja e funksioneve dhe kompetencave ligjore për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”.*

Kolegji i Posaçëm i Apelimit funksionon me një program të vetëm buxhetor, me emërtesën: “Veprimtaria e Apelimit të Rivlerësimit Kalimtar”. **Përshkrimi i Programit:** *“Mbështetja e veprimtarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; ushtrimin e juridiksionit disiplinor ndaj subjekteve të përcaktuara në ligj, si dhe shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të organeve të sistemit të drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore”.*

Qëllimi i politikës së programit: *“Funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”.*

Si tregues i performancës, i projektuar për të matur impaktin e këtij qëllimi, është përcaktuar: *“Pavarësia dhe funksionimi i sistemit ligjor”.*

Përcaktimi i vlerës bazë, si dhe i vlerës për tri vitet e ardhshme, për efekt të procesit të parashikimit të kërkesave buxhetore afatmesme, është kryer duke përdorur si burim informacioni studimet vjetore të publikuara nga “Freedom House”, organizatë e pavarur, financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, e specializuar në studime mbi demokracinë, respektimin e lirive dhe të drejtave, si dhe funksionimin e shtetit (<https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2024>).

Sa i përket vlerësimit të sistemit gjyqësor, ky studim paraqet rezultatet në formën e një indeksi me vlera nga 0 - 4, ku nr. 0 paraqet vlerësimin minimal dhe nr. 4 atë maksimal. Në raportin e vitit 2024, ku paraqitet vlerësimi për vitin 2023, sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë paraqitet në nivelin 3. Në këtë raport citohet përmirësimi i vlerësimit në vlerën 3 gjatë vitit 2023, për shkak të zhvillimeve të procesit të *Vettingut*. Kolegji ka gjykuar se, si rrjedhojë e finalizimit me sukses të

procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe krijimit e konsolidimit të organeve të reja të drejtësisë, në vitet në vijim, ky indeks do të vijojë të mbetet në nivelin 3 deri në vitin 2026.

Për realizimin e Programit Buxhetor është përcaktuar si objektiv kryesor:

Objekti 1 - *“Të shqyrtojë çështjet e ankimuara nën juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor”.*

Treguesi i performancës, i projektuar për të matur rezultatin e lidhur me këtë objektiv, është: *“Numri i çështjeve të përfunduara në raport me numrin e çështjeve të ankimuara”.* Vlera e projektuar për këtë tregues performance për vitin 2026, si viti i fundit i mandatit kushtetues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, është vlerësuar në masën 100%.

Deri më datën 31 dhjetor 2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar për shqyrtim 417 çështje të juridiksionit të rivlerësimit dhe janë shpallur 296 vendime të juridiksionit të rivlerësimit ose rreth 71% e çështjeve të regjistruara. Pra, në janar 2025, në Kolegj janë 121 çështje me status “të pashqyrtuara”.

Duke mbajtur parasysh edhe domosdoshmërinë e ruajtjes së cilësisë dhe standardeve të deritanishme në gjykim, Kolegji po vijon zbatimin e një programi të hartuar në bashkëpunim me ONM-në për çështjet që do të gjykohen gjatë vitit 2025, me qëllim përfundimin e shqyrtimit të rreth 80 ankimeve gjatë vitit 2025 dhe pjesën e mbetur, rreth 41 ankime, në 6-mujorin e parë të vitit 2026, duke iu shtuar numrit të këtyre çështjeve edhe numri i kërkesave me objekt *përrjashtim gjyqtari/heqje dorë nga gjykimi*, të cilat lidhen me to.

Po kështu, Kolegji ka për kompetencë ligjore dhe shqyrtimin e çështjeve në kuadër të juridiksionit disiplinor. Njëkohësisht, në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, janë paraqitur dhe një numër i lartë i kërkesave me objekt: *rishikim vendimi*, kërkesa këto të paraqitura nga ish-subjektet e rivlerësimit, të cilëve i ka përfunduar procesi i rivlerësimit në Kolegj.

Sa i takon të drejtës së ushtrimit të juridiksionit disiplinor ndaj subjekteve të përcaktuara në ligj, si dhe shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të organeve të sistemit të drejtësisë, për vendosjen e masave disiplinore, deri në 31 dhjetor 2024, në Kolegj janë regjistruar 22 çështje në total dhe janë marrë 19 vendime (9 vendime përfundimtare dhe 10 vendime për moskalim të çështjes në seancë). Ndërkohë, aktualisht, në Kolegj janë në shqyrtim rreth 30 kërkesa me objekt rishikim vendimi dhe 54 çështje, që lidhen me kërkesat e tjera procedurale në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit.

Bazuar në këto të dhëna statistikore, është parashikuar vlera e produktit “Çështje të shqyrtuara”, për vitin 2025, 83 çështje (80 të juridiksionit të rivlerësimit dhe 3 të juridiksionit disiplinor) dhe për vitin 2026, 44 çështje (41 të juridiksionit të rivlerësimit dhe 3 të juridiksionit disiplinor).

Sa u trajtua më sipër, buxheti total i parashikuar për vitin 2026 është 301.3 milionë lekë, nga të cilat 208 milionë lekë për aktivitetin e Kolegjit për 6-mujorin e parë të vitit 2026, paraqitur si Politikë Ekzistuese dhe 93.3 milionë lekë për funksionimin e Strukturës së Posaçme për mbylljen e aktivitetit, pas përfundimit të mandatit kushtetues të Kolegjit, për 6-mujorin e dytë të vitit 2026, paraqitur si Politikë e Re.

Ndërkohë, tavanit buxhetor i përcaktuar me VKM-në nr. 119, datë 26.02.2025, “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të PBA-së 2026 – 2028”, është 125.2 milionë lekë ose 60% e buxhetit të nevojshëm për funksionimin e institucionit, deri në përfundim të mandatit kushtetues.

Pavarësisht përcaktimit të mësipërm, në zbatim të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni C, pika 14 e tij, si dhe nenit 19, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kërkesat buxhetore për Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë hartuar bazuar në nevojat konkrete, duke argumentuar këto kërkesa, sipas formateve të miratuara në udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018, të Ministrisë të Financave. Gjithashtu, në interpretim të kuadrit ligjor për menaxhimin e sistemit buxhetor, faza e parë e përgatitjes së Projektdokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm njihet si faza strategjike dhe tavanet buxhetore janë të ndryshueshme.

Pra, kërkesat buxhetore për Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë hartuar bazuar në nevojat konkrete dhe nuk marrin në konsideratë tavanet indikative të miratuara për KPA-në, me VKM-në nr. 119, datë 26.02.2025, “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të PBA-së 2026 – 2028”.

Për më tepër, ndryshe nga sa parashikohet në VKM-në nr. 119, datë 26.02.2025, “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të PBA-së 2026-2028”, me ligjin nr.115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, është miratuar buxheti për vitin 2026, si pjesë e paketës së Projektbuxhetit Afatmesëm, në vlerë 137 milionë lekë, rreth 12 milionë lekë më i lartë.

Tabela më poshtë paraqet të dhëna mbi ecurinë e buxhetit për vitin 2024, parashikimin e realizimit për vitin 2025, kërkesat, si dhe tavanet e miratuara për vitin 2026, sipas VKM-së nr. 119, datë 26.02.2025.

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	2024		2025		2026	
		Ligji nr. 97/2024		Ligji nr. 115/2024		VKM nr. 119, datë 26.02.2025	
		Buxheti fillestar 2024	Realizimi i vitit 2024	Buxheti i miratuar për vitin 2025	Realizimi i pritshëm 2025	Tavani për vitin 2026	Kërkesa 2026
1	Pagat dhe sigurimet shoqërore	276,060	275,807	262,360	262,360	114,600	284,559
2	Shpenzime të tjera korente	24,290	20,039	23,640	23,640	8,640	14,840
3	Shpenzime kapitale të brendshme	2,000	1,289	2,000	2,000	2,000	2,000
	TOTALI	302,350	297,135	288,000	288,000	125,240	301,399

Ndërkohë, e ndarë sipas 6-mujorëve, sikurse u shpjegua më sipër, 6-mujori i parë i vitit 2026 është paraqitur si Politikë Ekzistuese dhe 6-mujori i dytë i vitit si politikë e re, parashikimet paraqiten në tabelën në vijim.

Në mijë lekë

<i>Pasqyra e kërkesave buxhetore për shpenzime korente për vitin 2026</i>					
Artikulli ekonomik	Kërkesa për vitin 2026	Tavani indikativ i miratuar	Politikë ekzistuese (janar-qershor)	Politikë e re (korrik-dhjetor)	Kërkesa mbi tavan
600+601	284,559	114,600	193,784	90,775	169,959
602	14,840	8,640	12,340	2,500	6,200
231	2,000	2,000	2,000	0	0
Totali	301,399	125,240	208,124	93,275	176,159

Në vijim paraqitet, në mënyrë të detajuar dhe të argumentuar, kërkesa për çdo artikull ekonomik, për vitin 2026.

1. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet për paga dhe shtesa të tjera për personelin, për vitin 2026, reflektojnë koston aktuale të punonjësve të KPA-së. Nëpërmjet këtij zëri shpenzimesh garantohet vijueshmëria e strukturave të burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale të tyre në fushat e veprimtarisë së KPA-së, si dhe në sigurinë e mirëfunksionimit të brendshëm administrativ. Kërkesat buxhetore në shpenzime personeli, për vitin 2026, janë përlllogaritur në vlerën totale **284.6 milionë lekë** dhe përfshijnë:

a) Vlerën **193.8 milionë lekë**, paga dhe sigurime shoqërore për periudhën janar – qershor 2026, për 67 punonjës, të miratuar me vendimin nr. 92/2017, të Kuvendit të Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe 4 (katër) punonjës me kontratë të përkohshme, miratuar me vendimin nr. 19, datë 09.01.2025, të Këshillit të Ministrave (për të cilët do të kërkohet miratimi edhe për vitin 2026), si politikë ekzistuese. Ky fond konsiston përkatësisht në: 181.8 milionë lekë për paga, 12 milionë lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Në këtë fond është përfshirë edhe një buxhet i përafërt, rreth **46 milionë lekë**, në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga Kodi i Punës, lidhur me shpërblimin për vjetërsi të punonjësve. Referuar nenit 152 të Kodit të punës, në përfundim të marrëdhënieve të punës që kanë zgjatur jo më pak se tre vjet, punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsinë, si në rastin e zgjidhjes së kontratës me afat të pacaktuar nga punëdhënësi. Sipas nenit 145 të Kodit, shpërblimi për vjetërsi është të paktën sa paga e një 15-ditëshi, mbi çdo vit pune të plotë.

b) Vlerën **90.8 milionë lekë**, paga dhe sigurime shoqërore, për periudhën korrik – dhjetor 2026, për 60 punonjës (Sekretari i Përgjithshëm, Këshilltarë të Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe punonjës administrativë). Ky fond konsiston përkatësisht në: 81.3 milionë lekë për paga, 9.5 milionë lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe, duke qenë se në këtë moment nuk janë miratuar aktet

rregullatore për funksionimin e kësaj njësie, ky fond, së bashku me një buxhet minimal në shpenzime operative, është përfshirë si Politikë e Re.

Në përlllogaritjen e fondit të pagave dhe të sigurimeve shoqërore jemi mbështetur në:

- Nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Pikat 3, 4 dhe 5, të nenit 29, si dhe nenin 70 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Nenin 12, ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM-në nr. 574, datë 09.10.2017, “Për përcaktimin e pagës mujore shtesë për shkak të vështirësisë, për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit”;
- Vendimin nr. 92/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, i ndryshuar;
- VKM-në nr. 325, datë 31.05.2023, e ndryshuar dhe VKM-në nr. 326, datë 31.05.2023, sa i takon punonjësve administrativë;
- Aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për pagesën e kontributit të sigurimit shoqëror dhe kontributit të sigurimit shëndetësor që punëdhënësi kryen për punëmarrësit.

2. Shpenzime operative

Buxheti për shpenzime operative përfshin tërësinë e mallrave dhe shërbimeve të domosdoshme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve që Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 i ngarkon Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Në përlllogaritjen e fondeve buxhetore për shpenzime operative jemi mbështetur kryesisht në treguesit e realizuar të shpenzimeve operative për vitin 2024, shpenzime të parashikuara për vitin 2025, si dhe kërkesat specifike që mund të kenë të bëjnë me ekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Në parashikimin e këtyre shpenzimeve, të cilat kanë rëndësi për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve operacionale, u morën parasysh nevojat e administratës, numri i personelit, shpenzimet e automjetit, amortizimi dhe zëvendësimi i pjesëve të konsumueshme të pajisjeve, konsumi mesatar i karburantit dhe i aktiveve qarkulluese etj.

Buxheti total i parashikuar në shpenzime operative për vitin 2026, sipas tavaneve indikative për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit është 8.6 milionë lekë, ndërsa kërkesat e Kolegjit për shpenzime operative janë në vlerën 12.3 milionë lekë, 43% më e lartë se tavani i vendosur sipas VKM-së nr. 119, datë 26.02.2025.

Në vijim janë paraqitur kërkesat për vitin 2025, sipas grupeve kryesore të shpenzimeve operative:

602.0 - Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme

Kjo kategori shpenzimesh, e përlllogaritur në vlerën **0.7 milion** lekë, përfshin zërat e mëposhtëm:

Në 000 lekë

Nr.	Materiale zyre dhe të përgjithshme	700
1	Kancelari, letër	350
2	Materiale për pastrim e higjieno-sanitare	200
3	Materiale elektrike, ndriçim etj.	50
4	Materiale për funksionimin e pajisjeve speciale	50
5	Furnizim dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme	50

Në hartimin e nevojave për artikujt: letër, kancelari dhe materiale pastrimi është mbajtur parasysh realizimi i këtyre zërave në tri vitet e fundit dhe realizimi i pritshëm për vitin 2025. Është mbajtur në konsideratë tavani i shpenzimeve i vendosur për vitin 2026, si dhe fakti i përfundimit të mandatit kushtetues të Kolegjit në qershor 2026, duke bërë të pamundur prokurimin e fondeve pas kësaj date.

602.1 - Materiale dhe shërbime speciale

Kjo kategori shpenzimesh, e përlogaritur në vlerën **1.5 milionë** lekë, përfshin zërat e mëposhtëm:

Në 000 lekë

Nr.	Materiale dhe shërbime speciale	1,540
1	Ilaçe dhe materiale mjekësore	10
2	Furnizime me ujë të pijshëm për seancat dhe personelin	150
3	Posta, abonim në shtypin e shkruar	70
4	Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik vendimesh, dosje gjyqësore etj.)	1,200
5	Dezinfektim i ambienteve	60
6	Të tjera materiale dhe shërbime speciale	50

- Në zërin “Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik vendimesh, dosje gjyqësore etj.” është parashikuar një buxhet i nevojshëm për blerjen e fashikujve dhe kutive për ruajtje të përhershme, të nevojshme për arkivimin e dosjeve gjyqësore dhe dokumentacionit administrativ.
- Në zërin “Ujë i pijshëm” është parashikuar mbulimi i nevojave për personelin e Kolegjit, si dhe palët pjesëmarrëse gjatë proceseve gjyqësore, për periudhën janar – qershor 2026.
- Në zërin “Dezinfektim i ambienteve” është planifikuar dezinfektimi kundër insekteve që mbartin patogjenë të dëmshëm për shëndetin e njeriut, me një frekuencë 2 herë/vit.

602.2 - Shërbime nga të tretët

Kjo kategori shpenzimesh, e përlogaritur në vlerën **3.3 milionë** lekë, përfshin zërat e mëposhtëm:

Në 000 lekë

Nr.	Shërbime nga të tretët	3,410
1	Elektricitet	850
2	Ujë	60
3	Shërbime telefonike	1,300
4	Posta, shërbim korrieri	200
5	Shërbime të printimit dhe të publikimit	1,000

- Në zërat “Elektricitet dhe ujë” është parashikuar konsumi 6-mujor në godinën aktuale të Kolegjit.

- Në zërin “Shërbime telefonike”, në zbatim të VKM-së nr. 855, datë 02.11.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 02.09.2020, “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, si dhe Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020, i cili ka miratuar kuotat maksimale për telefoninë celulare sipas funksioneve, është llogaritur vlera e kontratës institucionale për Titullarin e institucionit, Këshilltarët Ligjorë dhe Ekonomikë, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive, për një periudhë 6-mujore.
- Zëri “Shërbime printimi dhe publikimi” ka të bëjë me shërbimin e printimit për periudhën dhjetor 2025 – qershor 2026.

602.3 - Shpenzime transporti

Kjo kategori shpenzimesh, e përlogaritur në vlerën **0.56 milionë lekë**, përfshin zërat e mëposhtëm:

Në 000 lekë

Nr.	Shpenzime transporti	460
1	Karburant dhe vajra	150
2	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	150
3	Shpenzime siguracioni të mjeteve	60
4	Shpenzime të tjera transporti (parkim për automjetin e institucionit)	100

- Në zërin “Karburant gjatë vitit 2026”, është parashikuar një sasi prej 600 litër (100 litër /muaj) për automjetin e institucionit, por që është në varësi të procedurës së prokurimit.
- Në zërin “Pjesë këmbimi, goma dhe bateri”, me vlerë 50 mijë lekë, është vlerësuar prokurimi i pjesëve që mund të dëmtohen për automjetin e institucionit, të cilat nuk klasifikohen si shërbime, sipas vlerësimit të kryer nga shoferi i automjetit ose nga kontrolli që i kryhet automjetit, përpara se të kalojë kontrollin vjetor.
- Në zërin “Shpenzime të tjera transporti” është përfshirë rinovimi i kontratës me Bashkinë Tiranë për vendin e parkimit të automjetit të institucionit.

602.4 - Shpenzime udhëtimi

Kjo kategori shpenzimesh, e përlogaritur në vlerën **1.5 milionë lekë**, përfshin zërat e mëposhtëm:

Në 000 lekë

Nr.	Shpenzime udhëtimi	1,500
1	Udhëtim i brendshëm	0
2	Udhëtim jashtë shtetit	1,500

- Në zërin “Udhëtime jashtë vendit” janë parashikuar shpenzime të nevojshme për pjesëmarrje në takime e konferenca të ndryshme ndërkombëtare apo takime në kuadër të raportimit për Kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, në kuadër të negociatave për integrimin në Bashkimin Evropian. Baza ligjore për shpenzimet e parashikuara më sipër është VKM-ja nr. 870, datë 14.11.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870,

datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

602.5 - Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme

Kjo kategori shpenzimesh, e përlogaritur në vlerën **0.8 milion lekë**, përfshin zërat e mëposhtëm:
Në 000 lekë

Nr.	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	780
1	Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit	120
2	Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave	600
3	Shpenzime për mirëmbajtjen e programit financiar “Financa 5”	60

Në zërin “Për mirëmbajtje të zakonshme” janë përfshirë:

- Mirëmbajtja e pajisjeve të zyrës, përfshihet mirëmbajtja e serverëve, kompjuterave, pajisjeve, sistemit audio-video të instaluar në sallën e gjyqit, si dhe mirëmbajtja e kondicionerëve të dhomës së serverave të zyrës të institucionit, në vlerën 600 mijë lekë.
- Shpenzime për mirëmbajtje të automjetit të institucionit, ku përfshihen shërbime rutinë dhe ato të parashikuara në momentin e hartimit të planit.
- Shpenzime për mirëmbajtjen e programit financiar “Financa 5”, në vlerën 60 mijë lekë, parashikon asistencën e specialistëve të programit në faza të ndryshme, në lidhje me problematikat e ndryshme në modulet e këtij programi.

602.7 - Shpenzime për ekzekutim vendimi

Parashikimi i fondit në vlerën 3.7 milionë lekë, i përket detyrimit për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 4112, datë 27.06.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ky buxhet është parashikuar në këtë fazë të Projektbuxhetit, duke qenë se deri në këtë moment nuk është gjykuar ende ankimi i depozituar nga Kolegji në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me nr. 313/8 prot., datë 26.08.2024 për kundërshtimin e dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm, si dhe ankimit të plotë me nr. 313/9 prot., datë 03.09.2024, për kundërshtimin e zgjidhjes në themel të çështjes.

602.9 - Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative

Kjo kategori shpenzimesh, e përlogaritur në vlerën **0.3 milion lekë**, përfshin zërat e mëposhtëm:

Në 000 lekë

Nr.	Shpenzime të tjera operative	250
1	Shpenzime kompensimi për zyrtarët e zgjedhur (pasaportë diplomatike)	60
2	Shpenzime për tatim dhe taksa të paguara nga institucioni	50
3	Rimbushje MKZ	20
4	Mirëmbajtje faqe zyrtare	120

- Në zërin “Kompensim për zyrtarët e zgjedhur (pasaportë diplomatike)” është parashikuar fondi standard prej 60,000 lekë për pasaporta diplomatike për Gjyqtarët e Kolegjit.

- Shpenzime për tatim dhe taksa të paguara nga institucioni është parashikuar një fond prej 50,000 lekësh për pagesën e taksave vjetore vendore, siguracion automjeti dhe tatime të tjera të institucionit.
- Në zërin “Rimbushje MKZ” është parashikuar fondi për shërbimin periodik të rimbushjes së bombolave MKZ.
- Kërkesa për shpenzime operative për vitin 2026, në vlerën 12.3 milionë lekë është konsideruar si pjesë e politikës ekzistuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Pjesë e politikës së re për vitin 2026, në vlerën 2.5 milionë lekë, është vlera e mallrave dhe e shërbimeve të parashikuara për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2026, pas përfundimit të mandatit kushtetues të Kolegjit, sikurse u shpjegua në hyrje të këtij materiali.

3. Shpenzimet për investime

Për vitin 2026, Kolegji i Posaçëm të Apelit ka parashikuar në investime fondin 2 milionë lekë, aq sa është edhe tavani buxhetor i përcaktuar për vitin 2026, përdorimi i këtij fondi parashikohet si më poshtë:

1. Blerje pajisje zyre të nevojshme për personelin. Parashikimi për këtë grup investimesh është llogaritur në vlerën 1,000 mijë lekë.
2. Blerje pajisje elektronike/UPS etj., për rastet e dëmtimeve gjatë vitit, të cilat nuk mund të riparohen, dhe nevoja të tjera që mund të shfaqen gjatë vitit. Parashikimi për këtë grup investimesh është llogaritur në vlerën 1,000 mijë lekë.

Bazuar në përcaktimet e udhëzimit për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm, kjo kërkesë është trajtuar në kategorinë shpenzime administrative kapitale dhe përfshihet në politikat ekzistuese për projektet e investimeve publike.

Bashkëlidhur, gjeni formatet standarde për hartimin e kërkesave buxhetore për vitin 2026.